

Lutje

Lutje përmbledhëse të përmendura në
Kuran dhe **Sunet**

Përmbledhi dhe përktheu nga gjuha angleze:
Doruntina Bunjaku

Recensoi: **Hoxhë Petrit Perçuku**

Lutje

Lutje përmbledhëse të
përmendura në **Kuran**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۞ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ۞ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ۞
 مَلِكِ يَوْمِ الدِّينِ ۞ إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ۞ أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ۞
 صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ ۞

Bismil-lāhir-Rahmānir-Rahīm. Elhamdulil-lāhi Rab-bil
 'ālemīn. Er-Rahmānir-Rahīm. Māliki jewmid-dīn. Ij-jāke
 na'budu we ij-jāke neste'īn. Ihdines-sirātal mustekīm.
 Sirātal-ledhīne en'amte 'alejhim gajril magdūbi 'alejhim we
 led-dāl-līn.

1. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!
2. Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve,
3. të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit,
4. Sunduesit të Ditës së Gjykimit.
5. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje
ndihmë kërkojmë.
6. Udhëzona në rrugën e drejtë!
7. Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi e jo
në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd,
as në të atyre që janë të humbur!

Surja El-Fātiha 1-7

رَبَّنَا تَقَبَّلْ مِنَّا إِنَّكَ أَنْتَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ ﴿١٢٧﴾

Rabbenā tekabbel minnā inneke entes-semī-ul
'Alīm.

**“O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (këtë vepër)! Me të
vërtetë, Ti je Ai që dëgjon dhe di gjithçka!”**

Surja El-Bekarah 127

رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ ﴿٢١﴾

Rabbenā ātinā fid-dunjā haseneten we fil āhirati
haseneten we kinā a'dhāben-nār.

**“Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të
mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i
Zjarrit (të Xhehenemit)!”**

Surja El-Bekarah 201

رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَثَبِّتْ أَقْدَامَنَا وَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ
الْكَافِرِينَ ﴿٢٥٠﴾

Rabbenā efrig ‘alejnā sabran we theb-bit ekedāmenā
wen’surnā ‘alel kawmil kāfirīn.

**“Zoti ynë! Na pajis me durim, na forco këmbët
tona dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar!”**

Surja El-Bekarah 250

رَبَّنَا لَا تُؤَاخِذْنَا إِنْ نَسِينَا أَوْ أَخْطَأْنَا رَبَّنَا وَلَا تَحْمِلْ عَلَيْنَا إِصْرًا كَمَا حَمَلْتَهُ
 عَلَى الَّذِينَ مِنْ قَبْلِنَا رَبَّنَا وَلَا تُحَمِّلْنَا مَا لَا طَاقَةَ لَنَا بِهِ ۖ وَاعْفُ عَنَّا وَاعْفِرْ لَنَا
 وَارْحَمْنَا أَنْتَ مَوْلَانَا فَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ ﴿٢٨٦﴾

Rabbenā lā tu'āhidhnā in-nesīnā ew ah'ta'nā.
 Rabbenā we lā tah'mil a'lejnā is'ran kemā hameltehū
 a'lel ledhīne min kabēlinā. Rabbenā we lā tuham-
 milnā mā lā tākate lenā bihi we'afu a'nnā wegfirenā
 werham'nā ente mewlānā fen'sur'nā 'alel kawmil
 kāfirīn.

**“Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose
 veprojmë pa qëllim! Zoti ynë, mos na ngarko barrë
 të rëndë, ashtu si i ngarkove ata para nesh! Zoti
 ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta
 bartim! Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe
 na mëshiro! Ti je Mbrojtësi Ynë! Prandaj na jep
 fitore kundër atyre që nuk besojnë!”**

Surja El-Bekarah 286

رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً إِنَّكَ
 أَنْتَ الْوَهَّابُ ﴿٨﴾

Rabbenā lā tuzig kulūbenā baë'de idh hedejtenā we
 hebëlenā mil-ledunke rahmeten inneke entel Weh-
 hāb.

**“O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen
 (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e
 drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je
 Dhuruesi i Madh!”**

Surja Āli ‘Imrān 8

رَبَّنَا إِنَّكَ جَامِعُ النَّاسِ لِيَوْمٍ لَا رَيْبَ فِيهِ إِنَّ اللَّهَ لَا يُخْلِفُ الْمِيعَادَ ﴿٩﴾

Rabbenā inneke xhāmi'un-nāsi lijew'min lā rajbe fīhi
innAll-llāhe lā juhliful mī'ād.

**“O Zoti ynë! Ti do t'i mbledhësh njerëzit në një
Ditë për të cilën nuk ka dyshim. Me të vërtetë,
Allahu nuk e shkel premtimin.”**

Surja Āli 'Imrān 9

رَبَّنَا إِنَّنَا ءِٰمَنَّا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ ﴿١٦﴾

Rabbenā innenā āmen-nā fagfir'lenā dhunūbenā we kinā 'adhāben-nār.

“Zoti ynë! Me të vërtetë kemi besuar, andaj na i fal gjynahet tona dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit!”

Surja Āli ‘Imrān 16

اَللّٰهُمَّ مٰلِكَ الْمُلْكِ تُؤْتِي الْمُلْكَ مَنْ تَشَاءُ وَتَنْزِعُ الْمُلْكَ مِمَّنْ تَشَاءُ
وَتُعِزُّ مَنْ تَشَاءُ وَتُذِلُّ مَنْ تَشَاءُ بِيَدِكَ الْخَيْرُ اِنَّكَ عَلٰى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيْرٌ
﴿٦٦﴾ تُوَلِّجُ اللَّيْلَ فِي النَّهَارِ وَتُوَلِّجُ النَّهَارَ فِي اللَّيْلِ وَتُخْرِجُ الْحَيَّ مِنَ الْمَيِّتِ
وَتُخْرِجُ الْمَيِّتَ مِنَ الْحَيِّ وَتَرْزُقُ مَنْ تَشَاءُ بِغَيْرِ حِسَابٍ ﴿٦٧﴾

All-llāhumme Mālikel mulki tu'til mulke men teshā-u we tenzi'ul mulke mim-men teshāu we tu-'iz-zu men teshā-u we tudhil-lu men teshā, bijedikel hajr, inneke 'alā kul-li shej'in kadīr. Tūlixhul-lejle fin-nehāri we tūlixhun-nehāre fil lejli we tuhrixhul haj-je minel mej-jiti we tuhrixhul mejjite minel haj-ji we terzuku men teshā'u bigajri hisāb.

“O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë. Ti bën që nata të hyjë tek dita dhe që dita të hyjë tek nata. Ti e nxjerr të gjallën prej së vdekurës dhe të vdekurën e nxjerr prej së gjallës. Ti i jep kujt të duash pa kufij.”

Surja Āli ‘Imrān 26-27

رَبِّ هَبْ لِي مِنْ لَدُنْكَ ذُرِّيَّةً طَيِّبَةً إِنَّكَ سَمِيعُ الدُّعَاءِ ﴿٣٨﴾

Rabbi hebēlī mil-ledunke dhur-rij-jeten taj-jibeten inneke semī-'ud-du'ā.

“Zoti im! Dhuromë nga ana Jote pasardhës të mirë! Se Ti, me të vërtetë, je Dëgjues i lutjes!”

Surja Āli 'Imrān 38

رَبَّنَا ءَامَنَّا بِمَا أُنزِلَتْ وَاتَّبَعْنَا الرَّسُولَ فَاكْتُبْنَا مَعَ الشَّاهِدِينَ ﴿٥٣﴾

Rabbenā āmen-nā bimā en'zelte wet-tebaë'ner-rasūle fek'tubënā me'ash-shāhidīn.

“Zoti ynë! Ne besojmë atë që na ke shpallur dhe pasojmë të Dërguarin. Na shkruaj pra, bashkë me dëshmitarët!”

Surja Āli ‘Imrān 53

رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَإِسْرَافَنَا فِي أَمْرِنَا وَثَبِّتْ أَقْدَامَنَا وَانصُرْنَا
 عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ ﴿١٤٧﴾

Rabbena'gfir lenā dhunūbenā we isrāfenā fī emrinā
 we thebbit akēdāmenā wensurnā 'alel kawmil
 kāfirīn.

**“O Zoti ynë! Na i fal gjynahet tona dhe teprimin
 në punën tonë, na i forco këmbët (në istikam) dhe
 na ndihmo kundër popullit jobesimtar!”**

Surja Āli ‘Imrān 147

رَبَّنَا مَا خَلَقْتَ هَذَا بَاطِلًا سُبْحَانَكَ فَقِنَا عَذَابَ النَّارِ ﴿١٩١﴾ رَبَّنَا
 إِنَّكَ مَنْ تَدْخِلِ النَّارَ فَقَدْ أَخْرَجْتَهُ ۖ وَمَا لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ ﴿١٩٢﴾

Rabbenā mā halekēte hādhā bātilen subhāneke fekinā adhāben-nāra. Rabbenā inneke men tudēhilin-nār fekadë ahzejtehu we mā lidh-dhālimīne min ensār.

“O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit. O Zoti Ynë, cilindo që Ti e fut në zjarr, Ti e ke poshtëruar atë. Dhe për mohuesit nuk do të ketë kurrfarë ndihmuesi.”

Surja Āli ‘Imrān 191-192

رَبَّنَا إِنَّا سَمِعْنَا مُنَادِيًا يُنَادِي لِلْإِيمَنِ أَنْ ءَامِنُوا بِرَبِّكُمْ فَآمَنَّا
 رَبَّنَا فَاعْفُ رَ لَنَا ذُنُوبَنَا وَكَفِّرْ عَنَّا سَيِّئَاتِنَا وَتَوَقَّأ مَعَ الْأَبْرَارِ ﴿١٩٣﴾

Rabbenā innenā semi'nā munādijej-junādī lil īmāni en āminū birabbikum fe āmen-na. Rabbenā fagfir lenā dhunūbenā we kef-fir a'n-nā sej-jiātinā we tewef-fenā me'al ebērār.

“O Zoti Ynë! Ne dëgjuam një thirrës që na ftonte në besim: “Besoni Zotin tuaj!” Dhe kështu besuam. O Zoti Ynë! Na i fal gjynahet tona, na i shlyej gabimet dhe bëna që të vdesim me të mirët!”

Surja Āli ‘Imrān 193

رَبَّنَا وَعَاتِنَا مَا وَعَدْتَنَا عَلَىٰ رُسُلِكَ وَلَا تُخْزِنَا يَوْمَ الْقِيَمَةِ إِنَّكَ لَا
تُخْلِفُ الْمِيعَادَ ﴿١٩٤﴾

Rabbenā we ātinā mā we at-tenā a'lā rusulike we lā
tuhzinā jewmel kijāmeti Inneke lā tuhliful mī'ād.

**O Zoti Ynë! Na e jep shpërblimin që na ke
premtuar nëpërmjet të dërguarve të Tu dhe mos na
poshtëro në Ditën e Kiametit! Se Ti, me të vërtetë,
nuk e shkel premtimin e dhënë!”**

Surja Āli 'Imrān 194

رَبَّنَا ءَامِنَّا فَٱكْتُبْنَا مَعَ ٱلشَّٰهِدِينَ ﴿٨٣﴾

Rabbenā āmen-nā fek'tubënā me'ash-shāhidīn.

“O Zoti ynë! Ne besojmë, prandaj na llogarit ndër dëshmitarët e Tu!”

Surja El-Māideh 83

رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنْفُسَنَا وَإِنْ لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ
الْخَاسِرِينَ ﴿٢٣﴾

Rabbenā dhalem'nā enfusenā we il-lem tagfirlenā we
ter'hamnā lenekūnen-ne minel-hāsirīn.

**“O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah,
prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron,
ne vërtet që do të jemi nga të humburit.”**

Surja El-A'rāf 23

رَبَّنَا لَا تَجْعَلْنَا مَعَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٤٧﴾

Rabbenā lā texhëa'lnā mea'l kawmidh-dhālimīn,

“O Zoti ynë! Mos na hidh midis njerëzve të këqij!”

Surja El-A'rāf 47

رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَتَوَقَّفْنَا مُسْلِمِينَ ﴿١٢٦﴾

Rabbenā efrig 'alejnā sabran we tewef-fenā muslimīn.

“O Zoti ynë, na jep durim të madh dhe bëna të vdesim myslimanë!”

Surja El-A'rāf 126

أَنْتَ وَلِيُّنَا فَاعْفِرْ لَنَا وَارْحَمْنَا وَأَنْتَ خَيْرُ الْغَافِرِينَ ﴿١٥٥﴾ وَأَكْتُبْ
لَنَا فِي هَذِهِ الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ إِنَّا هُدْنَا إِلَيْكَ ﴿١٥٦﴾

Ente Welij-junā fagfir'lenā werhamnā we ente
hajrul gāfirīn. Wek'tub lenā fī hādhihid-dunjā
haseneten we fil āhirati innā hudēnā ilejke.

**“Ti je Mbrojtësi ynë, andaj falna dhe mëshirona! Ti
je më i miri i mëshiruesve! Na cakto të mira në këtë
botë dhe në tjetrën, sepse veç tek Ti ne kthehemi.”**

Surja El-A'rāf 155-156

حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ ﴿١٢٩﴾

HasbijAllāhu lā ilāhe il-lā Huwe ‘Alejhi tewek-keltu
we huwe Rabbul ‘Arshil ‘Adhīm.

**“Më mjafton Allahu, s'ka të adhuruar me të drejtë
përveç Tij. Unë mbështetem tek Ai; Ai është Zot i
Fronit të Madh!”**

Surja Et-Teube 129

رَبَّنَا لَا تَجْعَلْنَا فِتْنَةً لِّلْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٨٥﴾ وَنَجِّنَا بِرَحْمَتِكَ مِنَ الْقَوْمِ
الْكَافِرِينَ ﴿٨٦﴾

Rabbenā lā texhë'alnā fitneten lil kawmidh-dhālimīn.
We nexh-xhinā birahmetike minel kawmil kāfirīn.

**“O Zoti ynë, mos na bëj sprovë për popullin
keqbërës (duke i lënë të na shkatërrojnë), dhe
shpëtona me mëshirën Tënde, nga populli
mohues!”**

Surja Jūnus 85-86

رَبِّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أَسْأَلَكَ مَا لَيْسَ لِي بِهِ عِلْمٌ وَإِلَّا تَغْفِرْ لِي وَتَرْحَمْنِي
أَكُن مِّنَ الْخَاسِرِينَ ﴿٤٧﴾

Rabbi innī eūdhu bike en es'eleke mā lejse lī bihī
'ilmun, we il-lā tagfirlī we terhamnī ekum-minel
hāsirīn.

**“O Zoti im, mbështetem tek Ti për Të të mos
kërkuar gjëra, për të cilat nuk kam dijeni. Nëse Ti
nuk më fal dhe nuk më mëshiron, do të jem nga të
humburit”.**

Surja Hūd 47

فَاطِرَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ أَنْتَ وَلِيِّ فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ تَوَفَّنِي
مُسْلِمًا وَأَلْحِقْنِي بِالصَّالِحِينَ ﴿١٠١﴾

Fātiras-semāwāti wel erdi Ente Welīj-ji fid-dunjā wel
āhirati tewef-fenī muslimen we el'hikēnī bis-sālihīn.

**“O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je Mbrojtësi im
edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër! Bëj që të
vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët
(në botën tjetër)!”**

Surja Jūsuf 101

رَبِّ اجْعَلْ هَذَا الْبَلَدَ آمِنًا وَاجْنُبْنِي وَبَنِيَّ أَنْ نَعْبُدَ الْأَصْنَامَ ﴿٣٥﴾

Rabbixhë'al hādhel belede āminen wexhë'nubnī we
benij-je en-naë'budel asnām.

**“O Zoti im, bëje të sigurt këtë qytet dhe më ruaj
mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve!”**

Surja Ibrāhīm 35

رَبِّ اجْعَلْنِي مُقِيمَ الصَّلَاةِ وَمِنْ ذُرِّيَّتِي رَبَّنَا وَتَقَبَّلْ دُعَاءِ ﴿٤٠﴾

Rabbixhë'alnī mukīmes-salāti we min dhur-rij-jetī.
Rabbenā we tekab-bel du'ā.

“O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet!”

Surja Ibrāhīm 40

رَبَّنَا اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِلْمُؤْمِنِينَ يَوْمَ يَقُومُ الْحِسَابُ ﴿٤١﴾

Rabbena'gfirli we li wālidej-je we lil mu'minīne
jewme jekūmul hisāb.

**“O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe
besimtarët në Ditën, kur do të jepet llogari!”**

Surja Ibrāhīm 41

رَبِّ اَرْحَمُهُمَا كَمَا رَبَّيَانِي صَغِيرًا ﴿٢٤﴾

Rabbir'hamhumā kemā rabbejānī sagīrā.

“O Zoti im, mëshiroji ata (prindërit e mi), ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!”

Surja El-Isrā' 24

رَبِّ أَدْخِلْنِي مُدْخَلَ صِدْقٍ وَأَخْرِجْنِي مُخْرَجَ صِدْقٍ وَاجْعَلْ لِي
 مِنْ لَدُنْكَ سُلْطَانًا نَّصِيرًا ﴿٨٠﴾

Rabbi edëhilmī mudëhale sidëkin we ahrixhënī
 muhraxhe sidëkin wexhë'al-lī mil-ledunke sultānen-
 nesīrā.

**“O Zoti im, më shpjer në një hyrje të kënaqur, më
 nxirr nga një dalje të kënaqur dhe më dhuro nga Ti
 fuqi, që do të më ndihmojë!”**

Surja El-Isrā' 80

رَبَّنَا آتِنَا مِن لَّدُنكَ رَحْمَةً وَهَيِّئْ لَنَا مِنْ أَمْرِنَا رَشَدًا ﴿١٠﴾

Rabbenā ātinā mil-ledunke rahmeten we hej-ji'ë lenā
min emrinā rashedā.

**“O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe
përgatitna për sjellje të drejtë!”**

Surja El-Kehf 10

رَبِّ أشرح لي صدري ﴿٢٥﴾ وَيسر لي أمري ﴿٢٦﴾ وَأحلل عُقدَةً مِن
لِسَانِي ﴿٢٧﴾ يَفقهوا قولي ﴿٢٨﴾

Rabbish'rahlī sadērī we jes-sirlī emrī wahlul
ukëdetem-mil-lisānī jefkahū kawlī.

**“O Zoti im, zgjeroma kraharorin tim, lehtësoma
punën time, dhe zgjidhma nyjen e gjuhës sime, që
ata të kuptojnë fjalën time!”**

Surja Tā Hā 25-28

رَبِّ زِدْنِي عِلْمًا ﴿١١٤﴾

Rabbi zidënī 'ilmā.

“O Zoti im, shtoma dijeninë!”

Surja Tā Hā 114

أَنِّي مَسْنِيَ الضُّرِّ وَأَنْتَ أَرْحَمُ الرَّحِيمِينَ ﴿٨٣﴾

Ennī mes-senijed-durr-rru we ente er'hamurr-rrāhimīn.

“Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!”

Surja El-Enbijā' 83

لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ ﴿٨٧﴾

Lā ilāhe il-lā ente subhāneke innī kuntu minedh-dhālimīn.

“S’ka të adhuroar me të drejtë, përveç Teje! Qofsh i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar!”

Surja El-Enbijā’ 87

رَبِّ لَا تَذَرْنِي فَرْدًا وَأَنْتَ خَيْرُ الْوَارِثِينَ ﴿٨٩﴾

Rabbi lā tedhernī ferdēn we ente hajrul wāarithīn.

“O Zoti im, mos më lër vetëm (pa fëmijë), e Ti je trashëgimtari më i mirë.”

Surja El-Enbijā’ 89

رَبِّ أَنْزِلْنِي مُنْزَلًا مُبَارَكًا وَأَنْتَ خَيْرُ الْمُنْزِلِينَ ﴿٢٩﴾

Rabbi enzilnī munzelem-mubāraken we ente hajrul munzilīn.

“Zoti im, më zbarko në vend të bekuar, se Ti je më i miri për të na zbarkuar.”

Surja El-Mu’minūn 29

رَبِّ فَلَا تَجْعَلْنِي فِي الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٩٤﴾

Rabbi felā texhë'alnī fil kawmidh-dhālimīn.

“O Zoti im, mos më lër mua me popullin keqbërës!”

Surja El-Mu'minūn 94

رَبِّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ هَمَزَاتِ الشَّيْطَانِ ﴿٩٧﴾ وَأَعُوذُ بِكَ رَبِّ أَنْ
يَحْضُرُونِ ﴿٩٨﴾

Rabbi e'udhu bike min hemezātish-shejātīni we
e'ūdhu bike Rabbi ej-jahdurūn.

**“O Zoti im, kërkoj të më mbrosh nga nxitjet e
djajve, dhe tek Ti mbështetem, o Zoti im, që të mos
i kem pranë meje.”**

Surja El-Mu'minūn 97-98

رَبَّنَا ۖ آمَنَّا ۖ فَاغْفِرْ لَنَا ۖ وَارْحَمْنَا ۖ وَأَنْتَ خَيْرُ الرَّحِيمِينَ ﴿١٠٩﴾

Rabbenā āmen-nā fagfir'lenā werhamnā we ente
hajrur-rāhimīn.

**“O Zoti ynë, ne kemi besuar, andaj na fal dhe na
mëshiro! Ti je më i miri i mëshiruesve!”**

Surja El-Mu'minūn 109

رَبِّ اغْفِرْ وَارْحَمْ وَأَنْتَ خَيْرُ الرَّاحِمِينَ ﴿١١٨﴾

Rabbig'fir werham we Ente hajrur-rāhimīn.

“O Zoti im, fal dhe mëshiro, se Ti je më i miri i mëshiruesve!”

Surja El-Mu'minūn 118

رَبَّنَا أَصْرِفْ عَنَّا عَذَابَ جَهَنَّمَ إِنَّ عَذَابَهَا كَانَ غَرَامًا ﴿٦٥﴾

Rabbenas'rif 'an-nā adhābe xhehenname inne adhābehā kāne garāmā.

“O Zoti ynë, largoje prej nesh ndëshkimit e Xhehenemit, sepse, me të vërtetë, dënimi i tij është i përjetshëm.”

Surja El-Furkân 65

رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ وَاجْعَلْنَا

لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا ﴿٧٤﴾

Rabbenā hebē'lenā min ezwāxhinā we dhur-rij-jātinā
kur-rate 'aë'junin wexhë'alnā lil mut-tekīne imāmā.

**“O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe
trashëgimtarët tanë, ç'është prehje për sytë tanë
dhe bëna shembull për të mirët!”**

Surja El-Furkân 74

رَبِّ هَبْ لِي حُكْمًا وَأَلْحِقْنِي بِالصَّالِحِينَ ﴿٨٣﴾ وَاجْعَلْ لِي لِسَانَ
صِدْقٍ فِي الْآخِرِينَ ﴿٨٤﴾ وَاجْعَلْ لِي مِنْ وَرَثَةِ جَنَّةِ النَّعِيمِ ﴿٨٥﴾

Rabbi hebëlī hukmen we el'hikënī bis-sālihīn,
wexhë'al-lī lisāne sidëkin fil āhirīn, wexhë'alnī min
weratheti xhennetin-ne'īm.

**“O Zoti im, më dhuro dituri dhe më radhit me të
mirët! Bëj që të përmendem për të mirë te breznitë
e ardhshme dhe më bëj një nga trashëgimtarët e
Xhenetit të begatë!”**

Surja Esh-Shu'arā' 83-85

وَلَا تُحْزِنِي يَوْمَ يُبْعَثُونَ ﴿٨٧﴾ يَوْمَ لَا يَنْفَعُ مَالٌ وَلَا بَنُونَ ﴿٨٨﴾ إِلَّا مَنْ
 أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ ﴿٨٩﴾

We lā tuhzinī jewme jubë'athūn, jewme lā jenfe'u
 mālun we lā benūn il-lā men etAll-llāhe bikalbin
 selīm.

**“Dhe mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen
 njerëzit, në Ditën, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi
 as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër
 të pastër tek Allahu!”**

Surja Esh-Shu’arā’ 87-89

رَبِّ أَوْزِعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ وَعَلَىٰ وَالِدَيَّ وَأَنْ
أَعْمَلَ صَالِحًا تَرْضَاهُ وَأَدْخِلْنِي بِرَحْمَتِكَ فِي عِبَادِكَ الصَّالِحِينَ ﴿١٩﴾

Rabbi ewzi'nī en eshkura nië'metikel-letī en'amte
'alej-je we 'alā wālidej-je we en 'aë'mele sālīhan
terdāhu we edēhīlnī bi rahmetike fī 'ibādikes-sālīhīn.

**“O Zoti im, më frymëzo që të jem mirënjohës për
mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të
mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të
jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në
gjirin e robërve të Tu të devotshëm!”**

Surja En-Neml 19

رَبِّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي فَاغْفِرْ لِي ﴿١٦﴾

Rabbi innī dhalemtu nefsī fag’firlī.

**“O Zoti im! Njëmend, Unë i kam bërë keq vetes,
andaj më fal!”**

Surja El-Kasas 16

رَبِّ نَجِّنِي مِنَ الْقَوْمِ الظَّالِمِينَ ﴿٢١﴾

Rabbi nexh-xhinī minel kawmidh-dhālimīn.

“O Zoti im, më shpëto prej popullit keqbërës!”

Surja El-Kasas 21

عَسَىٰ رَبِّي أَن يَهْدِيَنِي سَوَاءَ السَّبِيلِ ﴿٢٢﴾

‘Asā rabbī ej-jehdijenī sewā es-sebīl.

“Shpresoj se Zoti im do të më tregojë rrugën e drejtë!”

Surja El-Kasas 22

رَبِّ إِنِّي لِمَا أَنْزَلْتَ إِلَيَّ مِنْ خَيْرٍ فَقِيرٌ ﴿٢٤﴾

Rabbi innī limā enzelte ilej-je min hajrin fekīr.

“Zoti im, çfarëdo dhuntie që të më japësh, unë jam nevojtar!”

Surja El-Kasas 24

رَبِّ أَنْصُرْنِي عَلَى الْقَوْمِ الْمُفْسِدِينَ ﴿٣٠﴾

Rabbin'surnī 'alel kawmil mufsidīn.

**“O Zoti im, më ndihmo kundër popullit që bën
mbrapshti!”**

Surja El-'Ankebūt 30

رَبِّ هَبْ لِي مِنَ الصَّالِحِينَ ﴿١٣٣﴾

Rabbi heblī mines-sālihīn.

“O Zoti im, dhuromë fëmijë prej të mirëve!”

Surja Es-Sāffāt 100

رَبَّنَا وَسِعْتَ كُلَّ شَيْءٍ رَّحْمَةً وَعِلْمًا فَاغْفِرْ لِلَّذِينَ تَابُوا وَاتَّبَعُوا
سَبِيلَكَ وَقِهِمْ عَذَابَ الْجَحِيمِ ﴿٧﴾

Rabbenā wesië'te kul-le shej'ir-rahmeten we 'ilmen
fagfir lil-ledhīne tābū wet-tebe'ū sebīleke wekihim
adhābel xhehīm.

**“O Zoti ynë, Ti përfshin çdo gjë me mëshirën dhe
dijeninë Tënde, prandaj fali ata që janë penduar e
që ndjekin rrugën Tënde dhe ruaji ata prej dënimit
të Zjarrit flakërues!”**

Surja Gāfir 7

رَبَّنَا وَأَدْخِلْهُمْ جَنَّاتِ عَدْنٍ الَّتِي وَعَدْتَهُمْ وَمَنْ صَلَحَ مِنْ آبَائِهِمْ
 وَأَزْوَاجِهِمْ وَذُرِّيَّاتِهِمْ إِنَّكَ أَنْتَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٨﴾ وَفِيهِمُ السَّيِّئَاتِ
 وَمَنْ تَقِ السَّيِّئَاتِ يَوْمَئِذٍ فَقَدْ رَحِمْتَهُ وَذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿٩﴾

Rabbenā we edēhil’hum xhennāti adēni nil-letī we
 ‘at-tehum we men saleha min ābāihim we
 ez’wāxhihim we dhur-rij-jātihim Inneke Entel ‘Azīzul
 Hakīm. Wekihimus-sej-ji-āt we men tekis-sej-ji-āti
 jewme’idhin fekadē rahimtehu we dhālike huwel
 fewzul ‘adhīm.

**“O Zoti ynë, shpjeri ata në kopshtet e Adnit, të
 cilat ua ke premtuar, së bashku me të devotshmit
 prej prindërve të tyre, bashkëshorteve të tyre dhe
 pasardhësve të tyre! Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.
 Dhe shpëtoji ata nga e keqja! Atë që Ti e shpëton
 nga e keqja atë Ditë, Ti e ke mëshiruar; e ky, me të
 vërtetë, është shpëtimi i madh!”**

Surja Gāfir 8-9

رَبِّ أَوْزَعْنِي أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ الَّتِي أَنْعَمْتَ عَلَيَّ وَعَلَىٰ وَالِدَيَّ وَأَنْ
 أَعْمَلَ صَالِحًا تَرْضَاهُ وَأَصْلِحْ لِي فِي ذُرِّيَّتِي ۖ إِنِّي تُبْتُ إِلَيْكَ وَإِنِّي
 مِنَ الْمُسْلِمِينَ ﴿١٥﴾

Rabbi ewzië'nī en eshkura nië'metkel-letī en-'amte
 'alej-je we 'alā wālidej-je we en 'aëmele sālihan
 terdāhu we as'lih'lī fī dhur-rij-jetī innī tubtu ilejke we
 innī minel muslimīn.

**“O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për
 begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të
 mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të
 jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek
 Ty kthehem i penduar dhe Ty të dorëzohem!”**

Surja El-Ahkāf 15

رَبَّنَا اغْفِرْ لَنَا وَلِإِخْوَانِنَا الَّذِينَ سَبَقُونَا بِالْإِيمَانِ وَلَا تَجْعَلْ فِي
 قُلُوبِنَا غِلًّا لِلَّذِينَ ءَامَنُوا رَبَّنَا إِنَّكَ رَءُوفٌ رَحِيمٌ ﴿١٢﴾

Rabbenāg'fir lenā we li ihwāninel-ledhīne sebekūnā
 bil īmāni we lā texhë'al fī kulūbinā gil-lel-lil-ledhīne
 āmenū Rabbenā inneke Raūfur-Rahīm.

**“O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët
 kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat
 tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti
 ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!”**

Surja El-Hashr 10

رَبَّنَا عَلَيْكَ تَوَكَّلْنَا وَإِلَيْكَ أَنَبْنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ ﴿١٠٠﴾

Rabbenā 'Alejke tewek-kelnā we Ilejke enebnā we Ilejkel mesīr.

**“O Zoti ynë, tek Ti mbështetemi, Ty të drejtohem
dhe tek Ti do të kthehem.”**

Surja El-Mumtehineh 4

رَبَّنَا لَا تَجْعَلْنَا فِتْنَةً لِلَّذِينَ كَفَرُوا وَاعْفِرْ لَنَا رَبَّنَا إِنَّكَ أَنْتَ
الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٥٧﴾

Rabbenā lā texhë'alnā fit'netel-lil-ledhīne keferū
wag'firlenā Rabbenā Inneke entel 'Azizul Hakīm.

**“O Zoti ynë, mos na bëj sprovë për jobesimtarët
dhe falna ne, o Zot. Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe
i Urti.”**

Surja El-Mumtehineh 5

رَبَّنَا أَتْمِمْ لَنَا نُورَنَا وَآغْفِرْ لَنَا إِنَّكَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٨﴾

Rabbenā et'mim lenā nūranā wag'firlenā Inneke 'alā kul-li shej'in Kadīr.

**“O Zoti ynë, përsose dritën tonë dhe falna ne!
Vërtet Ti je i Fuqishëm për çdo gjë.”**

Surja Et-Tahrīm 8

رَبِّ ابْنِ لِي عِنْدَكَ بَيْتًا فِي الْجَنَّةِ ﴿١١﴾

Rabbibëni lî 'Indeke bejten fil xhenneh.

“O Zoti im! Ndërtomë një banesë tek Ti, në Xhenet.”

Surja Et-Tahrīm 11

رَبِّ اغْفِرْ لِي وَلِوَالِدَيَّ وَلِمَنْ دَخَلَ بَيْتِي مُؤْمِنًا وَلِلْمُؤْمِنِينَ
وَالْمُؤْمِنَاتِ وَلَا تَزِدِ الظَّالِمِينَ إِلَّا تَبَارًا ﴿٦٤﴾

Rabbig'firlī we liwālidej-je we limen dehale bejtije
mu'minen we lil-mu'minīne wel mu'mināti we lā
tezididh-dhālimīne il-lā tebārā.

**“O Zoti im, falmë mua dhe prindërit e mi, si dhe
çdo besimtar, që kërkon strehim në shtëpinë time!
Fali të gjithë besimtarët e besimtare, ndërsa
keqbërësve shtoj vetëm shkatërrim!”**

Surja Nūh 28

قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ ﴿١﴾ لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ ﴿٢﴾ وَلَا أَنْتُمْ
 عِبِدُونَ مَا أَعْبُدُ ﴿٣﴾ وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَّا عَبَدْتُمْ ﴿٤﴾ وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ
 مَا أَعْبُدُ ﴿٥﴾ لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ ﴿٦﴾

Kul jā ej-juhel kāfirūn. Lā a'ëbudu mā ta'budūn. We
 lā entum 'ābidūne mā a'budë. We lā ene 'abidum mā
 'abet-tum. We lā entum 'ābidūne mā a'budë. Lekum
 dīnukum we lijedīn.

1. Thuaj: “O ju mosbesimtarë!
2. Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni
3. dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj.
4. Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju
i adhuroni
5. dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë
adhuroj!
6. Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!”

Surja Kāfirūn 1-6

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ۝ اللَّهُ الصَّمَدُ ۝ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ۝ وَلَمْ يَكُنْ
لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ۝

Kul huwAll-Ilāhu ehadë. All-Ilāhus-Samedë. Lem
jelidë we lem jüledë. We lem jekul-lehū kufuwen
ehadë.

1. Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!
2. Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet
gjithçka në amshim.
3. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur.
4. Dhe askush nuk është i barabartë
(a i krahasueshëm) me Atë!”

Surja El-Ihlās 1-4

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ﴿١﴾ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ﴿٢﴾ وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ
 ﴿٣﴾ وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ ﴿٤﴾ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ ﴿٥﴾

Kul eūdhu bi Rabbil-felekë. Min sher-ri mā halekë. We min sher-ri gāsikin idhā wekabë. We min sher-rin-nef-fā-thāti fil 'ukadë. We min sher-ri hāsidadin idhā hasedë.

1. Thuaj: “Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit,
2. që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar
3. dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri
4. dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje (duke bërë magji)
5. dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë.”

Surja El Felek 1-5

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ﴿١﴾ مَلِكِ النَّاسِ ﴿٢﴾ إِلَهِ النَّاسِ ﴿٣﴾ مِنْ شَرِّ
الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ ﴿٤﴾ الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ ﴿٥﴾ مِنَ
الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ ﴿٦﴾

Kul eūdhu bi Rabbin-nās. Melikin-nās. Ilāhin-nās. Min
sher-ril weswāsil han-nās. El-ledhī juwes'wisu fī
sudūrin-nās. Minel xhinneti wen-nās.

1. Thuaj: “Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve,
2. Sundimtari i njerëzve,
3. i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve,
4. nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt)
5. e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve,
6. (qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!”

Surja En-Nās 1-6

Lutje

Lutje përmbledhëse të
përmendura në **Sunet**

«اللَّهُمَّ فَتِّهِني فِي الدِّينِ».

Allahumme fek-kihnī fid-dīni.

O Allah, më mundëso ta kuptoj fenë.

Buhariu 143. Muslimi 2477

«اللَّهُمَّ بَاعِدْ بَيْنِي وَبَيْنَ خَطَايَايَ كَمَا بَاعَدْتَ بَيْنَ
 الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ اللَّهُمَّ نَقِّنِي مِنَ الْخَطَايَا كَمَا يُنَقَّى
 الثَّوْبُ الْأَبْيَضُ مِنَ الدَّنَسِ اللَّهُمَّ اغْسِلْ خَطَايَايَ بِالْمَاءِ
 وَالثَّلْجِ وَالْبَرَدِ».

All-llāhumme bā'id bejnī we bejne hatājāje kemā
 bā`ad'te bejnel-meshriki wel-magribë. All-llāhumme,
 nek-kinī minel-hatājā kemā junek-kath-thewbul
 ebjedu mined-denes. All-llāhumma-gsil hatājāje bil
 mā'i weth-thelxhi wel beradë.

**O Allah, më largo mua nga mëkatet, ashtu siç e ke
 larguar lindjen nga perëndimi. O Allah, më pastro
 nga mëkatet, ashtu siç pastrohet rroba e bardhë
 prej njollave të zeza. O Allah, më pastro nga
 mëkatet me ujë (shi), borë dhe akull (breshër).**

Buhariu 744, 181. Muslimi 419

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ وَمِنْ عَذَابِ النَّارِ
وَمِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَالْمَمَاتِ وَمِنْ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ».

All-llāhumme in-nī e`ūdhu bike min 'adhābil kabër,
we min 'adhābin-nār, we min fitnetil mahjā wel
memāt, we min fitnetil mesīhid-dexh-xhāl.

**O Allah, më mbroj nga dënimi në varr, nga dënimi
me zjarr, nga sprova e jetës dhe e vdekjes, si dhe
nga sprova e Mesihut të rrejshëm (Dexhallit).**

Buhariu 1377

«اللَّهُمَّ مُنْزِلَ الْكِتَابِ وَمُجْرِيَ السَّحَابِ وَهَازِمَ الْأَحْزَابِ
اهْزِمْنَاهُمْ وَأَنْصُرْنَا عَلَيْهِمْ».

All-llāhumme munzilel kitāb, muxhërijes-sehāb, we
hāzimel ahzāb, ih'zim'hum wen surnā 'alejhim.

**O Allah, Ti që e zbritë Librin, që i lëvizë retë dhe
që i mposhtë ushtritë (e jobesimtarëve)! Mposhti
ata dhe na ndihmo kundër tyre!**

Buhariu 3024, 3025. Muslim 1742

«اللَّهُمَّ ثَبِّتْنِي وَاجْعَلْنِي هَادِيًا مَهْدِيًّا».

All-llāhumme theb-bitnī wexhë'alnī hādijen meh'dij-jen.

O Allah, më bëj të palëkundur (në fe), të udhëzuar dhe udhëzues për të tjerët.

Buhariu 3035, 3036

«اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى
 إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ اللَّهُمَّ بَارِكْ عَلَى
 مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ
 إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ».

All-llāhumme sal-li 'alā Muhammedin we 'alā `āli
 Muhammed, kemā sal-lejte 'alā Ibrāhīme we 'alā `āli
 Ibrāhīme in-neke Hamīdun Mexhīdë. All-llāhumme bārik
 'alā Muhammedin we 'alā āli Muhammed, kemā bārakte
 'alā Ibrāhime we 'alā `āli Ibrāhime, in-neke Hamidun
 Mexhid.

O Allah, lavdëroje e nderoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit, ashtu siç e lavdërove dhe nderove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, se me të vërtetë Ti je i Lavdëruar e i Madhëruar. O Allah, bekoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit, ashtu siç e bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, se me të vërtetë Ti je i Lavdëruar dhe i Madhëruar.

Buhariu 3370, 6357

«اللَّهُمَّ يَسِّرْ لِي جَلِيسًا صَالِحًا».

Allaahumme jes-sirlī xhelīsen sālihan

O Allah, më mundëso një shok të mirë e të devotshëm.

Buhariu, 3742

«اللَّهُمَّ عَلِّمْنِي الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَفَقِّهْنِي فِي الدِّينِ».

All-llāhumme ļal-limnīl kitābe wel hikmete, we fek-
kihnī fid-dīni.

**O Allah, më mëso Kuranin (kuptimin e tij), urtësinë
(Sunetin) dhe më bëj ta kuptoj fenë.**

Buhariu 3756, 143,75

«اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي اللَّهُمَّ اجْعَلْنِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ فَوْقَ كَثِيرٍ مِنْ خَلْقِكَ مِنْ
النَّاسِ اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي ذَنْبِي وَأَدْخِلْنِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ مُدْخَلًا كَرِيمًا».

All-llahumme-gfirlī. All-llahummexhë'alnī jewmel
kijāmeti fewka kethīrin min halkike minen-nāsi. All-
llahumme-gfirlī dhenbī we edëhlnī jewmel kijāmeti
mudëhalen kerīmen.

**O Allah, më fal mua! O Allah, në Ditën e Kijametit
më bëj të jem më lartë se shumë prej krijesave Tua
prej njerëzve. O Allah, m'i fal mëkatet dhe më bëj
të hyj në portën fisnike (në xhenet).**

Buhariu 4324, Muslimi 2498

«اللَّهُمَّ أَنْتَ رَبِّي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ خَلَقْتَنِي وَأَنَا عَبْدُكَ وَأَنَا عَلَى عَهْدِكَ
وَوَعْدِكَ مَا اسْتَطَعْتُ أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا صَنَعْتُ أَبُوءُ لَكَ بِنِعْمَتِكَ
عَلَيَّ وَأَبُوءُ لَكَ بِذَنْبِي فَاغْفِرْ لِي فَإِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ».

All-llāhumme ente Rabbī lā ilāhe il-lā ente. Halekētenī we
ene `abduke we ene `alā `ahdike we wa`dike mesteta`t.
E`ūdhu bike min sher-ri mā sanaë`t. Ebū'u leke bi
nië`metike `alej-je, we ebū'u leke bi dhenbī fagfirlī fe in-
nehu lā jegfirudh-dhunube il-lā ent.

**O Allah, Ti je Zoti im, nuk ka të adhurar me të drejtë
përveç Teje. Ti më ke krijuar mua dhe unë jam rob i Ty.
Unë do të përpiqem sa të kem mundësi që t'i
përmbahem marrëveshjes që kam bërë me Ty dhe
premtimit që të kam dhënë (se do të të adhuroj dhe nuk
do të të shoqëroj asgjë në adhurim, do t'i përmbush
urdhrat dhe do të largohem nga ndalesat e Tua). Kërkoj
mbrojtjen Tënde nga e keqja e asaj që e kam bërë. Unë
i pranoj të gjitha të mirat që Ti m'i ke dhënë, dhe po
ashtu i pranoj edhe mëkatet e mia; andaj të lutem më
fal, se askush tjetër përveç Teje nuk i fal mëkatet.**

«اللَّهُمَّ لَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ نُورُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ قَيِّمُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ وَلَكَ الْحَمْدُ أَنْتَ الْحَقُّ وَعَدُّكَ حَقٌّ وَقَوْلُكَ حَقٌّ وَلِقَاؤُكَ حَقٌّ وَالْجَنَّةُ حَقٌّ وَالنَّارُ حَقٌّ وَالسَّاعَةُ حَقٌّ وَالنَّبِيُّونَ حَقٌّ وَمُحَمَّدٌ حَقٌّ اللَّهُمَّ لَكَ أَسْلَمْتُ وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ وَبِكَ آمَنْتُ وَإِلَيْكَ أَنْبْتُ وَبِكَ خَاصَمْتُ وَإِلَيْكَ حَاكَمْتُ فَاعْفِرْ لِي مَا قَدَّمْتُ وَمَا أَخَّرْتُ وَمَا أَسْرَرْتُ وَمَا أَعْلَنْتُ أَنْتَ الْمُقَدِّمُ وَأَنْتَ الْمُؤَخِّرُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ -أَوْ- لَا إِلَهَ غَيْرُكَ».

All-Ilāhumme lekel-hamd; Ente nūrus-semawāti wel erdi we men fihinn. We lekel-hamdu; Ente kaj-jimus-semewāti wel erdi we men fihinn. We lekel-hamdu; Entel-hakku, we waë'duke hakkun, we kawluke hakkun, we likāuke hakkun, wel-xhen-netu hakkun, wen-nāru hakkun, wes-sā'atu hakkun, wen-nebij-jüne hakkun, we Muhammedun hakkun. Allāhume leke eslemtu, we 'alejke tewek-keltu, we bike āmentu, we ilejke enebētu, we bike hāsamtu, we ilejke hākemtu. Fagfirli mā kad-demtu we me eh-hartu, we me esrartu, we mā 'aë'lentu. Entel mukad-dimu, we entel mu'eh-hiru. Lā ilāhe il-lā ente (Lā ilāhe gajruke).

O Allah, Ty të takon lavdërimi dhe falënderimi; Ti je drita e qiejve dhe e tokës dhe çka në mes tyre. Ty të takon lavdërimi dhe falënderimi; Ti je Mbikëqyrës i qiejve dhe i tokës, dhe (i asaj) çfarë ka në mes tyre. Ty të takon lavdërimi dhe falënderimi; Ti je i Vërtetë; premtimi Yt është i vërtetë; fjala Jote është e vërtetë; takimi me Ty është i vërtetë; Xheneti është i vërtetë; Xhehenemi është i vërtetë; Kijameti është i vërtetë; pejgamberët janë të vërtetë dhe Muhammedi (sal-lallahu alejhi ue sel-lem) është i vërtetë. O Allah, Ty të dorëzohem (të nënshtrohem), tek Ti mbështetem, Ty të besoj dhe tek Ti kthehem me pendim, për Ty armiqësohem dhe tek Ti kthehem për gjykim: M'i fal mëkatet e kaluara dhe të tashme, ato që i kam bërë në vetmi (fshehtë) dhe ato që i kam bërë haptazi. Ti je Ai që lartëson kë të duash (me urtësinë Tënde) dhe Ti je Ai (që me urtësinë Tënde) e lë prapa (e përul) kë të duash. Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Teje.

Buhariu 6317, Muslimi 769a

«اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي ظُلْمًا كَثِيرًا وَلَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ فَاعْفِرْ لِي مَغْفِرَةً مِنْ عِنْدِكَ وَارْحَمْنِي إِنَّكَ أَنْتَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ».

All-llāhumme in-nī dhalemtu nefsi dhulmen kethīran, we lā jagfirudh-dhunūbe il-lā ente, fagfirli magfiraten min 'indike wer-hamni, in-neke entel Gafūrur-Rahīm.

O Allah, unë i kam bërë padrejtësi të shumta vetes sime dhe askush tjetër përveç Teje nuk i fal mëkatet; andaj më fal mua me faljen Tënde dhe më mëshiro, se vërtetë Ti je Falës dhe Mëshirues i madh.

Buhariu 834, 6326. Muslimi 2705a

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ الْعَظِيمُ الْحَلِيمُ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ رَبُّ الْعَرْشِ
الْعَظِيمِ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ رَبُّ السَّمَوَاتِ وَرَبُّ الْأَرْضِ وَرَبُّ
الْعَرْشِ الْكَرِيمِ».

Lā ilāhe il-Allāhul Adhīmul Halīm. Lā ilāhe il-Allāhu
Rabbul 'arshil 'adhim. Lā ilāhe il-Allāhu Rabbus-
semewāti we Rabbul erdi we Rabbul 'arshil kerim.

**Nuk ka të adhurar me të drejtë përveç Allahut, të
Madhërishmit, të Butit! Nuk ka të adhurar me të
drejtë përveç Allahut, Zotit të Arshit madhështor!
Nuk ka të adhurar me të drejtë përveç Allahut,
Zotit të qiejve e të tokës dhe Zotit të Arshit Fisnik!**

Buhariu 6346, Tirmidhiu 3435, El Edeb el Mufrad 702

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ جَهْدِ الْبَلَاءِ وَدَرَكِ الشَّقَاءِ وَسُوءِ الْقَضَاءِ وَشَمَاتَةِ الْأَعْدَاءِ».

All-llāhumme in-nī e'ūdhu bike min xhehdil belā'i, we derakish-shekā'i, we sū'il kadā'i, we shemātetil aë'dā'i.

O Allah, kërkoj të më mbrosh nga belaja e papërballueshme, nga zhytja në mjerim, nga vendimi Yt (që më bën të pikëllohem e të bie në gjëra të këqija) dhe nga gëzimi i armikut (me fatkeqësitë e mia).

Buhariu 6347, Muslimi 2707

«اللَّهُمَّ فَأَيُّمَا مُؤْمِنٍ سَبَبْتُهُ فَاجْعَلْ ذَلِكَ لَهُ قُرْبَةً إِلَيْكَ
يَوْمَ الْقِيَامَةِ».

All-llāhumme fe'ej-jumā mu'minin sebebētuhu,
fexhë`al dhālike lehū kurbeten ilejke jewmel
kijāmehe.

**O Allah, cilindo prej besimtarëve që e kam fyer
apo ofenduar, të lutem bëje këtë (vepër) shkak që
ai të jetë më afër Teje në Ditën e Kijametit.**

Buhariu 6361

«رَضِينَا بِاللَّهِ رَبًّا وَبِالْإِسْلَامِ دِينًا وَبِمُحَمَّدٍ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ رَسُولًا نَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الْفِتَنِ».

Radīnā bil-lāhi Rabben we bil Islāmi dīnen we bi
Muhamedin sal-lAllāhu alejhi we sel-lem rasūlen.
Ne'ūdhu bil-lāhi minel fiten.

**Jemi të kënaqur me Allahun si Zot, Islamin për fe
dhe Muhamedin (sal-lAllahu alejhi ue sel-lem) si të
Dërguar. O Allah, na ruaj nga fitnet!**

Buhariu 6362, Ibn Maxheh 3870

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْهَمِّ وَالْحَزَنِ وَالْعَجْزِ وَالْكَسَلِ
وَالْبُخْلِ وَالْجُبْنِ وَضَلَعِ الدَّيْنِ وَغَلَبَةِ الرِّجَالِ».

All-llāhumme in-nī e`ūdhu bike minel-hemmi wel-
hazen, wel-`axhëzi wel-kesel, wel-buhli wel-xhubën,
we dale`id-dejni we galebetir-rixhāl.

**O Allah, më mbroj nga brengat dhe pikëllimet, nga
paaftësia dhe përtacia, nga koprracia dhe frika,
nga zhytja në borxhe dhe mposhtja që njerëzit ma
bëjnë mua.**

Buhariu 6363, Nesa'iu 5453

«اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْكَسَلِ وَالْهَرَمِ وَالْمَأْثَمِ وَالْمَغْرَمِ وَمِنْ
فِتْنَةِ الْقَبْرِ وَعَذَابِ الْقَبْرِ وَمِنْ فِتْنَةِ النَّارِ وَعَذَابِ النَّارِ وَمِنْ شَرِّ
فِتْنَةِ الْغِنَى وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ فِتْنَةِ الْفَقْرِ».

All-llāhumme in-ni e'ūdhubike minel keseli, wel heram, wel me'them, wel magram, we min fitnetil kabëri, we 'adhābil kabëri, we min fitnetin-nāri we adhebin-nāri, we min fitnetil ginā we e'ūdhu bike min fitnetil fakër.

